


# EUROPEAN MOBILITY WEEK

16-22 SHTATOR 2020

## 10 mësimet që mësuam nga izolimi PËR LËVIZSHMËRI MË TË MIRË URBANE:



# 1

**Hapësira publike është e çmueshme;** tani më shumë se kurrë duhet theksuar se qytetet janë të rëndësishme për njerëzit, e jo për automjetet (të parkuar apo në lëvizje nëpër rrugët me shumë kors). Politikat e trafikut mund të ndryshohen për kohë relativisht të shkurtë.

# 2

**Kuptuam vlerën e punëtorëve më të duhur, të cilët deri më tani ishin të padukshëm.** Mes tyre janë edhe të punësuarit e transportit publik, që na ndihmojnë të lëvizim. Me kapacitet të kufizuar të transportit publik, është me rëndësi që t'u japim prioritet personave që kanë më së shumti nevojë. Krahas kësaj, duhet ta rivendosim mirëbesimin ndaj transportit publik. Transporti publik është shumë i rëndësishëm për lëvizshmëri urbane të qëndrueshme dhe të sigurt.



# 3

**E padukshmeja u bë e dukshme:** ndotja e ajrit dhe zhurma nga trafiku janë zvogëluar si asnjëherë më parë. Evropianët shijuan ajër më të pastër dhe hapësira më të qeta urbane, e tani të gjithë duan që kështu të vazhdojë. Çfarë mund të bëjmë që ta mbajmë këtë trend, aq sa është e mundur?

# 4



**Bota jonë po ndryshonte shpejtë,** por nuk ka nevojë për ritëm të tillë. T'i marrim punët më shtruar dhe nëpër qytete të kufizojmë shpejtësinë maksimale në 30 km në orë ose madje edhe më ngadalë në zonat urbane.

# 5

**Tani shëndeti i organeve frymëmarrëse dhe stili aktiv i jetës janë më të rëndësishme:** hulumtimet e fundit tregojnë se ndotja dhe obesiteti dukshëm rrisin rreziqet shëndetësore nga COVID-19. Për këtë shkak, duhet të gjejmë mënyra për t'u mundësuar njerëzve të ecin apo të bëjnë biçikletë në mënyrë të sigurt nëpër qytetet tona. Të gjithë duhet të përpiqen që të mbajnë formën trupore dhe të bëjnë sport, e prandaj nuk na befason fakti që gjithkund nëpër shitore shohim se mund të blihen tesha e vegla për ushtrime. Sidoqoftë, ushtrimi me i mirë mbetet të ecurit dhe çiklizmi.



# 6

**Të punuarit nga shtëpia u bë diçka krejt e zakonshme dhe e mundshme** për shumicën, me ç'gjë u zvogëlua nevoja për të marrë pjesë në trafikun e përditshëm. Mirëpo, punëtorë të caktuar, për shkak të natyrës së punës, janë të detyruar të paraqiten në vendin e tyre të punës. Për këtë arsye, të punësuarit në atë lëmi dhe ekspertët për lëvizshmëri e planifikim urban, duhet bashkarisht të gjejnë zgjidhje që do të na ndihmojnë t'i kthehemi përditshmërisë sonë në mënyrë të sigurt.

# 7

**Çuarja e fëmijëve në shkollë** me automjet dukshëm shton ngarkesën në trafik. Për shkak të këtyre tolloive, nuk është e sigurt për fëmijët tjerë të shkojnë në shkollë në këmbë ose me biçikletë. Prandaj prindërit e tyre detyrohen t'i çojnë në shkollë me veturë, me çka krijohet një rreth vicioz nga i cili nuk dilet dot! Mësimi në distancë mund të ndihmojë në uljen e rreziqeve, por prapëseprapë nevojiten zgjidhje më të mira për të shkuar në shkollë.



# 8

**Veglat digjitale janë tepër të rëndësishme për shfrytëzimin efikas të sistemeve të trafikut,** por duhet të jenë të disponueshme për të gjithë. Për disa vite me radhë ekspertët për lëvizshmëri diskutojnë për lëvizshmërinë si shërbim (MaaS), me qëllim që të promovojnë stil jetë ku do të përdoren më shumë mënyra trafiku. Këtu shumë të dobishme janë aplikacionet përmes të cilave shkëmbehen informacione për zgjidhje trafiku me më pak ngarkesa ose përmes të cilave promovohet ecja, në vend se të ofrohen më shumë opsione për linja autobusi. Që të mund të shfrytëzoen këto vegla maksimalisht, banorët duhet të kenë qasje në to, si dhe të kenë njohuri digjitale.

# 9

**Blerja përmes internetit është një nga zjidhjet** që më së shumti u përdor gjatë kohës së karantinës, por si organizohet dërgesa? Nëse përdoren biçikleta për dërgesa e furnizime, fitojmë logjistikë me zero emetime!

# 10


**Disa njerëz janë më të ndjeshëm se të tjerët:** t'u bëjmë të mundur që nëpër qytete edhe ata të kenë qasje në sistemet e trafikut, sepse një qytet ku ka qasje një person në karrocë invalide, atëherë në të ka qasje secili.



# EUROPEAN MOBILITY WEEK

16-22 SHTATOR 2020

“Lëvizshmëri me zero-emetime për të gjithë”, e thjeshtë si një petull\*



Petulla i referohet teorisë së “ekonomisë së petullës”, e paraqitur nga ekonomistja Kejt Rofort nga Universiteti i Oksfordit (2017). Këtë teori tani e shfrytëzojnë disa qytete për t'u konsoliduar nga kriza e shkaktuar nga COVID-19. Në këtë teori ekonomia prezantohet si një petull dhe pjesa përreth paraqet vlerat maksimale ekologjike, ndërsa pjesa e brendshme është minimalja që nevojitet për një jetë të mirë. Të gjithë duhet të qëndrojmë në hapësirën e mesme/ të komfortit, pa rrëshqitur në vrimën në mes.

Marrë nga:

<https://www.kateraworth.com/doughnut/>

#MobilityWeek



## Cilat aktivitete do të realizohen gjatë JAVËS EVROPIANE TË LËVIZSHMËRISË 2020?

Varësisht nga rrethanat në vend, mund të organizoni disa nga aktivitetet e propozuara më poshtë.

Gjithmonë zbatoni rregullat dhe/ose rekomandimet aktuale për siguri.

- ✓ Mund të ecni dhe bëni biçikletë, por keni kujdes me hapësirën ku bëni këto aktivitete!
- ✓ Ofroni marshuta me guida që do t'i shpjegojnë rregullat e reja të sigurisë dhe do të sugjerojnë lokacione të ridestinuara nga parkime për automjete në hapësira të dedikuara për njerëz.
- ✓ Organizoni konferenca me pjesëmarrje të përfaqësuesëve nga më shumë qytete, si për shembull [konferenca e vitit të kaluar Qytetet ballkanike](#).
- ✓ Vendosni një kabinë informative ku do të jepen informacione ose analiza për trafikun gjatë periudhës më të vështirë të pandemisë së COVID-19.
- ✓ Bëni sondazhe për të identifikuar problemet dhe dëshirat për të përdorur hapësirat publike, si dhe për mënyrat e preferuara të levizjes.
- ✓ Nëse organizoni një event më të madh, bëhuni kreativ dhe bëni kujdes për distancën fizike. Ja një shembull për t'ju inspiruar: çiklistët holandezë përdornin bukë franceze baget, të varur në shpinën e tyre, për të treguar cila është distanca e sigurt për t'u tejkualuar nga automjetet.
- ✓ Organizoni llotari online me shpërblime që nxisin ecjen dhe çiklizmin.
- ✓ Realizoni fushata marketingu për të promovuar transportin publik dhe sigurinë që ofron ky lloj transporti.
- ✓ Organizoni gara kreative ku shpërblim kryesor do të jetë biletë vjetore/mujore për transport publik.
- ✓ Përdorni mediat sociale për të promovuar transportin inkluziv pa emetime dhe filloni bashkëpunimin me banorët lokalë, duke përdorur hashtagun oficial #MobilityWeek
- ✓ Organizoni sfida me gjurmë karboni; në treg ekzistojnë [disa aplikacione](#) që tregojnë rezultate të menjëhershme, pasi që të jenë shënuar të dhënat për itineraret e zakonshme të transportit. Tregoni njerëzve sa gjurmë karboni kanë ata dhe këshilloni si ta zvogëlojnë nivelin e tij.
- ✓ Organizoni gara në media sociale për fotografi personale (selfie) më të mirë duke përdorur mënyrë transporti ekologjik.
- ✓ Inkuadroni banorët dhe palët tjera të përfshira kur testohen shërbimet e reja për transport pa emetime, me qëllim të përmirësimit të aksesit dhe inkluzivitetit të transportit publik.
- ✓ Pse mos ketë rekord të ri botëror? Ka shumë rekorde botërore që mund të tejkalojnë. Përdorni imagjinatën tuaj dhe në bashkëpunim me banorët lokalë thyni rekordin botëror për lëvizshmëri me zero-emetime.

Këto janë vetëm disa nga aktivitetet që mund t'i organizoni këtë vit, krahas aktiviteteve tradicionale me shkollat, OJQ, bizneset lokale etj.

#MobilityWeek

